

Procesverbal

*Nga Mbledhja IX (e nëntë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë:
24.09.2024*

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja VIII;
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën IX; dhe
- 3) Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, anëtarë të Kuvendit, përfaqësues të OSBE-së! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen IX të rregullt të KPF-së për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar. I kemi tri pika të rendit të ditës. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës, urdhëroni!

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderuar të pranishëm! Sa i përket rendit të ditës për seancën e rregullt, ne e dimë që propozimin që unë e bëra për me e formue Komisionin për hetimin e veturave të Komunës, ai veç kaloi me shumicë votash, që u dashtë me qenë si pikë e rendit të ditës edhe ajo, apo e ke lënë për me e vazhdue në seancën e rregullt. Këtë s'po e di. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Uran! Unë e pata fjalën për rendin e ditës të KPF-së. Atëherë, kush është pro pikave të rendit të ditës për KPF? A ka kundër? A ka abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë, fillojmë te miratimi i procesverbalit. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Atëherë, vazhdojmë te pika e dytë: Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën IX. A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë, para se me nis me pikën e rendit të ditës, Urani e pat një pyetje, pse nuk e kam fut Komisionin për hetimet. Unë nuk e kam fut, për arsye se kjo pika ka kalue, por Komisioni ka pas ngecje dhe, në qoftë se e shihni të udhës, nesër e qesim. Mundeni me e propozue edhe mundeni me e qit prapë. Përndryshe, në qoftë se tërhiqet njëri prej Partisë VAKAT, atëherë e bëjmë, në qoftë se nuk hiqet, ajo pikë do të mbetet ashtu.

Uran Halimi: Ajo pikë është e votuar dhe e miratuar, e dini edhe ju vetë. Duhet me u vazhdue vetëm me u formue Komisioni. Ti e ke shumë të lehtë edhe të thjeshtë me e thirrë secilën parti në emër, me ta dhënë emrin. S'ka ngecje aty. Nëse ti e ke si parti, ta zëmë shembull, VAKAT-i që ka

ngec puna, ti e thirrish një përfaqësues të Partisë VAKAT, nëse ata thojnë që janë VAKAT, atëherë e marrim një anëtar. VAKAT edhe ajo partia tjetër – s'e di qysh e ka emrin – këtu ten a nuk ekzistojnë, këtu ka vetëm VAKAT. Ju e thirrni emrin prej VAKAT-it, e merrni anëtarin e Komisionit të VAKAT-it, edhe është shumë e thjeshtë kjo. Unë po besoj që nuk duhet me ngec, pse ka një mosmarrëveshje në mes partisë. Edhe ne e kemi rastin njëjtë sikur VAKAT-i, po e japim një emër të LVV-së. Kur ta shohim që po do me e marrë fjalën në emër të LVV-së, na edhe ia japim, se ajo realisht është e LVV-së.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të KPF-së, të nderuar të pranishëm! Unë vetëm dola t'ia jap një përgjigje Uran Halimit. Është e vërtetë që në seancën e kaluar ka qenë në rend të ditës formimi i Komisionit, mirëpo seanca e kaluar nuk është ndërprerë, ka përfunduar. Faktikisht, çdo gjë ka përfunduar me atë ditë. Unë po të tregoj qysh shkruan në rregullore dhe qysh është me ligj. Mirëpo, nesër është seanca tjetër, mundesh me dalë me propozue prapë, edhe Asambleja voton për këtë pikë dhe niset nga fillimi. Këtu e ke edhe zyrtarin ligjor, mundesh me e konsultue edhe jashtë seancës, për nesër me qenë i përgatitur.

Uran Halimi: Faleminderit kryetar për përgjigjen! Po besoj që e pyeta unë kryesuesen – edhe Rregullorja, meqenëse e ceke, është mirë nesër me ma pru edhe Rregulloren edhe e lexojmë bashkë. Nëse thotë Rregullorja ti qysh po thuesh, është okej, e propozojmë prapë. Mirëpo, në këtë Kuvend, kryetar, kur të votohet edhe numërohen votat, është diçka që kryhet. Sipas Rregullores që unë e kam lexue. Nëse ti e ke një rregullore që thotë qeshtu ju qysh po thoni, na e pranojmë, e propozojmë, e votojmë sërish, për ata që dojnë me e votue. Mirëpo, ajo pikë e rendit të ditës është e votuar.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Uran! Atëherë fillojmë te pika e dytë: Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi kryetar, kryesuese, kolegë! Unë nuk jam shumë ekonomist me këto shifra, por unë dua të dal veç te investimet kapitale. Kryetar, e di që po vjen era zgjedhje edhe në shkurt edhe në shtator, ju si parti e Lidhjes Demokratike na keni akuzue – unë ju kam disa herë – na keni akuzue që po kubëzime nëpër fshatra, nëpër shpia private mbi 90%, po ju e keni teprue 190%. Po e kqyri listën, mbi 100% mos të them, se ka dy-tri herë në do vende, kanalizimi, ndërtim, kubëzim, kanalizim, kubëzim, ndërtim, kanalizim... ia keni shkue hujin, projekte dyvjeçare mos

të folim. Projekte me ka 700 euro, 900 euro. Unë s'po e di çfarë projekti është ky, më kallxoni ju mu një rrugë që do të kubëzoni, që është publike? Të gjitha rrugët janë private, se nuk ka kërkund mo rrugë publike. Për shembull në fshatin Rrenc – unë nuk e di kryetar ti, këto listat a i bien qytetarët, a i bien delegatët, a i bien kryesia e fshatit, se na kur kemi qenë në pushtet... tash me rend t'i tregoj, prit kadale se s'po gutna. Deshta me të thonë, në fshatin Rrenc, projekt dyvjeçar, 5 mijë euro këtë vit dhe 59 mijë euro vitin tjetër. Edhe e ke këtu në fshatin Rrenc – kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i mureve mbrojtës – Arijeta vjen nga fshati Rrenc, e Rrenci është si Zhuri rrafsh. Unë s'po di çfarë mur mbrojtës në Rrenc kie me vu. 59 mijë euro, projekt dyvjeçar. 5 mijë këtë vit e ke çelë, plus për në mot 59 mijë euro. Unë të kam thënë, Rrencin me e shtrua me ari, me u përdor për një grusht vota mu nuk më pengon, se është fshati im. Po më kallxo ti mu, kubëzimi i cilave rrugë në fshatin Rrenc, ma konkretisht, edhe çfarë mure mbrojtës ke me bo në fshatin Rrenc? Kur është tepsia Rrenci, nuk ka nevojë mur mbrojtës. Le të ma kallxojë kryesuesja një mur mbrojtës që do ta bini...nuk ka, se është si toka e Vlashnjës. A ka mundësi mos me më ndërpre prej qatytë, se s'ke të drejtë me fol. Hiç s'ke të drejtë asnjë troh me folë, or ti djalë. Hiç more, unë ia futi çka të due, ti s'ke të drejtë, a mundish me kuptue, mos më pengo mu, të lutem, mos të më pengojë ose le të dalë jashtë. Unë s'po due me vazhdue pa u ndalë ai, e boll e këtij u bo mo. A ka mundësi mos me më pengue asnjë troh? S'ke të drejtë me më pengue, çka duesh me më pengue, urdhëroni përjashta. Ti paske të drejtë me më pengue mu në Komitet këtu. Çka po të doket vetja ty këtu? Helikopter, a? Po si mos të durohem, del përjashta, kush të ka thirrë ty këtu. Ani mos fol qatytë! Arijetë, a ka mundësi me e ndalë?

Arijeta Skeraj: Artan, ti mundesh me vazhdue!

Artan Loshaj: Jo, s'po due me vazhdue pa u ndalë ai! Po ti 14 vjet more hor na ke bo këtu. Të kam durue 14 vjet, s'un po më durojsh 4 muaj ti mu. Edhe 4-5 muaj të kanë mbet ty edhe shkojsh te shpia. Se kryetarit në fillim i kam thënë ky zotëri të ka ardhë për një mandat këtu edhe me të çue te shpia. Se ti e ke çue qeto në shpi edhe ti prapë kie me e çue. Mos të ia nisim privat na të dy. Me punësimet tua familjare, me dallaveret tua. Lëj ato muhabete ti, se na të dimë kush je ti shumë mirë, unë të di mirë kush je ty.

Arijeta Skeraj: Drejtor, a ka mundësi kur ta marrish fjalën ti me dalë me folë këtu.

Artan Loshaj: Arijetë, s'kam nerva tash, unë duhet me dalë edhe një herë.

Arijeta Skeraj: Atëherë, kur t'i jepet personit fjala, ju kisha lut asnjëri prej vendit mos me ndërhy në fjalim të asambleistit. Ju kisha lut, kjo është vërejtja e fundit, përndryshe detyrohem me e mbyllë takimin e KPF-së. Ju lutem, se edhe në seancën e fundit keni bo kështu, edhe e keni lënë vetë seancën edhe keni dalë. Ju lutem, kush doje ta merre fjalën, le ta merre, prej vendit asnjë nuk e lejoj, qoftë edhe kryetari i Komunës.

Uran Halimi: Te planifikimi buxhetor, vjet realisht, në shtator, unë nuke kam votue buxhetin. S'jam ndie shumë mirë që s'e kam votue buxhetin, se e kam bo një kërkesë, e ka pranue kryetari atë kërkesën. Moralisht s'jam ndie mirë hiç për atë punë, po u dasht mos me e votue. Kur e morëm materialin e seancës që kemi me e mbajt nesër, e pashë që s'ia ka vlejti me e votue vërtet këtë atë buxhetin e vitit të kaluar. Për arsye se, kur është bërë ndarja e buxhetit në fshatin Blaç, është bërë ndarje e njëanshme, edhe pse i përkas unë asaj mahalle, krejt përqendrimi edhe koncentrimi i buxhetit u konë i ndamë vetëm te një lagje e Blaçit. Unë kam kërkuar që prej 45 mijë euro, në fakt prej 34 mijë euro, kam kërkuar që 15 mijë euro me u nda për rrugën te "Ura e Haxhisë" që i themi na. Kryetari e ka pranue atë ndarjen buxhetore. S'ka fillue kurgjo hala aty me u punue, kryetar, s'e di a e dish. Veç një rrugë private ka qenë ajo, që shkon kah Gurra, nuk ka pas rrugë ma herët. Është duke u kubëzue rrugë private. Ndoshta ajo kthehet tash edhe bëhet rrugë me tamam, po ma herët ka kalue nëpër prona private. Domethënë, atë kërkesën për me e nda buxhetin, nashta kryetari s'e ka realizue pse unë s'e kam votue buxhetin, mirëpo është pranuar edhe votuar buxheti me ndryshimet e kërkuara nga ne delegatët e Kuvendit. Kryetar, pse nuk është nis punimi në atë pjesë, edhe pse është parapa prapë për vitin 2025. Qetu po e shoh edhe rregullimi i ujëmbledhësve dhe renovimi i kaptazhëve të ujësjellësit. Kjo është kërkesë e qytetarëve të fshatit Blaç qe tri vjet. Kryesia e fshatit Blaç, të vetmen kërkesë edhe në vitin 2022, edhe në vitin 2023 e kanë pas rregullimin e ujëmbledhësit. Në këtë rast e kanë bërë njëfarë projekti prej 20 mijë euro, edhe kanë planifikue që për vitin 2025 me u bo rregullimi i ujëmbledhësve. As në vitin 2022, as në vitin 2023, as në vitin 2024, nuk po rregullohen tre ujëmbledhësa. Tre ujëmbledhësa është punë shumë e vogël, po janë ata ujëmbledhësat që me dokumentacion – unë kam thënë gjithmonë – me dokumentacion i kanë rregullue njëherë. Vetëm në letra. Janë qeta ujëmbledhësa. Nëse janë rregullue me dokumentacion para tre viteve, kur u shkatërruan këta ujëmbledhësa? Ju vetë e qitni veten, e demantoni edhe e planifikoni rregullimin e ujëmbledhësve. Po të ishin rregullue ata ujëmbledhësa, nuk do të kish ndodhë që në kryesinë e fshatit Blaç, e njëjta dhe e vetmja kërkesë të ripërsëritet vit pas viti, për tri vjet radhazi. Ka qenë edhe atë vjet kur e keni rregullue ju në letra

ujëbledhës, ka qenë kërkesë për rregullimin e ujëbledhësave, edhe në vitin 2023 u konë e vetmja kërkesë kur është mbajtur debate publik – edhe me shkrim bile e ka çue kryesia e fshatit Blaç, ju nuk e keni përfillë – vitin 2024 që po e lëmë, ishalla rregullohen. E përshëndes nëse rregullohen, po qysh po e shoh edhe në vitin 2025 ka me qenë i njëjti projekt, e hiç s’po besoj që ka me qenë i realizueshëm. Për pjesën tjetër s’kam çka diskutoj, se sipas praktikës, kjo është veç një planifikim, realizimi është krejt tjetër prej planifikimit që ju na e servoni në letër.

Artan Loshaj: Kryetar, unë veç me ty kam punë, se vetë ke thënë unë jam kryetar i krejt qytetarëve të Komunës. Unë thashë edhe një herë, për fshatin Rrenc deshta me të pyet, 59 mijë euro i ke ndarë për vitin 2025 – kubëzimi dhe ndërtimi i mureve, domethënë një po e dikin këta drejtorët, po i mureve, sa mure janë? Është një projekt dyvjeçar, e pashë tenderi që kish dalë, 5 mijë euro këtë vit, projekti është nënshkruar me 69,901 euro. Domethënë, po i bjer këtë vit që do të vjen do t’i ndajmë na 58,901 euro. Shumë mirë ke bo, unë të thashë edhe një herë që është fushatë elektorale. Ku janë këto rrugë në Rrenc, a je t’u i dit – edhe Arijeta a ka mundësi me më tregue – cilat rrugë të fshatit Rrenc kubëzohen këtë vit edhe vitin 2025, me projekt dyvjeçar. Më vjen shumë mirë që ke nda mjete për fshatin Rrenc, unë jam i mendimit që edhe 50 mijë euro me i nda, buxhet me marrë ane-ane, se unë jam i Rrencit edhe qatë e kam bazën, edhe qatë jetoj edhe kam familjarë. Mu më vjen shumë mirë edhe votën kam me ta dhënë edhe kam me ta votue buxhetin. Veç, a ka mundësi me m’regue kryesuesja edhe kryetari, a jeni t’u e dit cilat rrugë, se unë s’po i di. Ke bo projekte – të thashë – ndërtim, ndërtim, kubëzim, kanalizim, ndërtim, ndërtim, ndërtim, kurrgjo s’ka mirë. E pashë një projekt në fshatin Brrut – 900 euro. Veç pak kryetar, se ju e dini që jam pak temperament edhe këta vartësit tu që i kien prej vendit i shtish me m’provokue edhe mos me i pa edhe numrat unë këtu, po unë edhe një herë nesër foli. Qe për shembull, një e kien numër 38 – 7497 euro. Kqyr çka ke shkruar: Asfaltimi i rrugës Brrut – Zgatar dhe rregullimi i rrugëve të asfaltuara Kuk, Kosavë, Pllajnik, Kapre, Brrut, Brezne, Buqe, Pllavë, Rrenc, Shajne, me 7 mijë euro. Ka 5 euro nuk po i bjer secilit fshat, unë nuk e di çka do të bojsh me 7 mijë euro. 20 fshatra. Asfaltim. Po me i qit tucanik bre, me 7 mijë euro s’mundesh me i mbërrë, e jo asfalt. Asfaltimi i rrugëve Brrut, Zgatar, dhe rregullimi i rrugëve të asfaltuara, Kuki, Kosava, Pllajniku, Kapre, Brrut, Brezne, Buqe, Pllavë. Veç me u sjellë ata, qekaq naftë harxhojnë. Mirë, kodi i projektit, ju i dini se drejtorin e keni shumë të zotin, i di krejt këto. Jo me emër jo, me drejtor, tetë drejtorë i ka, unë kam të drejtë me i përmend. Numër 21 – ndërtimi i kanalizimit, kubëzimi në rrugën ‘Ogradja’ në fshatin Brrut, 900 euro. Me siguri, me siguri ndonjë votues i fortë është i LDK-së, se 900 euro kubëzim,

tenderi me dalë 500 euro duhet me i harxhue ai personi. Po mirë, ndonjë derë kanë me e hek edhe kanë me i shtrua 900 euro.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! Sa për Rrencin, unë nuk jam kompetente me folë. Unë jam kryesuese edhe i di zakonisht ku bëhen ato punime, edhe kam qenë në ngjarje, por unë për atë punë nuk jam kompetent, është drejtori bashkë me kryetarin, ata të cilët kanë me e marë fjalën. E dyta, sa për politikë, Artan, njëjtë na, si qysh keni bo ju politikë, edhe unë kam nis në Rrenc të bëj politikë. Kështu që, është mirë që ti me e pranue politikën teme, se unë ta kam pranue tënden.

Bexhet Xheladini: Unë po i përgjigjem në fillim Artanit. Më akuzove për kubëzime, kanalizime etj. Ne edhe në fushatë elektorale e kemi pas. Unë kurrë nuk kam thënë gjatë fushatës elektorale që po i kubëzoni rrugët private. Asnjëherë. Nëse e ke ndie dikund që unë kam thënë po bëni kubëzime e kubëzime, nuk e ke ndie kërkund. Kur ka kubëzime, ka kanalizime, dihet që kur bëhet kanalizimi, prishet rruga. Normal që në paramasë edhe paralogari duhet me i parapa. Kanalizimin kur e bojsh, kur kalon ai nëpër rrugë, duhet me e parapa me e kthye në gjendje të mëparshme atë punë që e ke bo. Në Rrenc po thuesh që i keni nda afër 60 e diçka mijë euro për kubëzime. Në Rrenc, më urdhërin tim, kemi vendos që të gjitha rrugët që janë të pakubëzuara, që nuk i keni kubëzue ju edhe na gjatë këtyre dy viteve qeverisje, me i kubëzue të gjitha rrugët që janë brenda në Rrenc dhe të cilat janë ende pa u kubëzuar. Me sa e di unë, 99% e të gjitha rrugëve në Rrenc që kanë mbet pa u kubëzuar në të kaluarën – s’po akuzoj, edhe ne dy vite kemi qeveris, ky është viti i tretë, nuk i kemi krye, edhe ju s’i keni krye – qato që kanë mbet do t’i kubëzojmë. Ka mundësi që ka mbet edhe ndonjë, një ose dy, ishala nuk kanë mbet, po nëse mbet edhe ato do t’i kryejmë. Tea i 900 eurshi, është kanalizimi, është projekt i këtij viti, edhe ky është borxh i projektit që është kryer. Nuk do të bëhet aty punimi, po është borxh, vitin e ardhshëm do ta paraqesim në buxhet si borxh edhe do t’ia paguajmë. Nuk bëhet fjalë për asnjë kanalizim privat që ne ia kemi dhënë fjalën, ose është votues i joni. Është vetëm borxh. Edhe te 7 mijë e 400 e diçka euro, rreth 8 mijë euro te asfaltimi i rrugës Brrut, edhe ky është borxh i asfaltimit që kemi mbet. Pse quhet ai projekt, shumë i gjatë është? Është kodi i projektit të kaluar. Patjetër ne duhet me e shënue në tërësi emrin e projektit, sepse në bazë të atij kodit ne e bëjmë edhe pagesën. Këtu mo nuk ka punime, po edhe ky është borxh. Janë dy borxhe të cilat ne i kemi planifikue mos me iu mbet kompanive borxh. Në fshatin Blaç u përmend “Ura e Haxhisë”. Është tenderi në Zyrë të Prokurimit, unë tash fola në telefon, edhe ky projekt do të kryhet sivjet. Përveç “Urës së Haxhisë”, kish aty edhe kubëzime e

gërmime. Sa i përket ujëmbledhësit në fshatin Blaç, ju shumë herë e keni përmend këtë. Është mirë, masi po e përmendni shumë, me e çue këtë punë deri në fund, me e pa a u punuë nime, a s'u punue, a u pague, a s'u pague. T'i vëmë pikë kësaj pune, se edhe unë jam i interesuar me e ditë. Propozo një metodë, qysh të dësh ti edhe, ose lyp qasje në dokumente zyrtare. Nuk di a pat edhe pyetje tjetër, por te këto dy pyetje, mendoj se isha i qartë. Mundish me shkue me e vërtetue, ose nëse dësh, t'i bie dokumentet këtu tash me i pa. Jo të ujëmbledhësit, është i vitit të kaluar, s'muj me e gjet, por këto projektet e "Urës së Haxhisë" edhe të Parkut, unë i kam nënshkrue shpejt, muj me t'i gjet menjëherë. Unë ose në seancë nesër t'i bie, para seancës pa problem, të dyja këto.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Ma shtove disponimin, sinqerisht. Tash, përderisa po mundesh qeto dokumentat ma aktuale me m'i sjellë, lype edhe atë të ujëmbledhësave të fshatit Blaç, edhe unë kam qef me ia vu kapakin, se e kam teprue realisht. Nëse mundesh nesër me m'i sjellë edhe faturat çka kanë pague e çka jo. Ti s'ke nevojë me bo kërkesë për qasje, veç shkojsh i marrish faturat. Jo bre këto dyjat s'ka nevojë, se i kqyri edhe online këto, nuk prish punë. Po këtë faturën e ujëmbledhësave është mirë me ma pru, mos me bo qasje unë, se edhe po ngushtohen ata punëtorët tu kur po bëj qasje, masnej po ia nisni me ato orët e shoqes teme në Blaç, e ku e di çka po boni do lojna të ulëta, që mu për Zotin po më vjen marre kur po i boni. Faleminderit shumë!

Artan Loshaj: Kryesuese, unë prej teje nuk mora përgjigje, thaje kryetari është kompetent edhe drejtori. Unë konkretisht prej kryetarit nuk e kuptova cilat rrugë janë në fshatin Rrenc. Jo, unë e di ku po do me qit kjo, se është për vota. Bonja edhe ma ari, s'ta jep votën edhe pikë, s'është problem ajo punë. Ne të dy kemi qenë asambleistë vjet, kryetari tha ma herët nuk kamë thënë. Kryetar, kanë thënë asambleistët tu të të njëjtës parti, se ju po bëni kubëzim, kanalizim. Na kanë akuzue si LDK, ti atëherë për fat të keq s'ke qenë këtu, po vllavi yt, shokët tu, kolegët tu, asambleistat tu na kanë akuzue edhe akuza të rënda. Unë nesër këtu në projektor kam me i qit kolegët e mi, të partië tënde, ku na kanë thënë kubëzim, kanalizim, rrugë private po bëni, deri e detyruan kryetarin e Komunës me marrë vendim që pronat private mos të kubëzohen. Edhe vendimi i ish-kryetarit Shabani është hala i varur në Urbanizëm. Unë po due me e ditë prej kryesuese, se kemi qenë asambleistë të vjetër këtu, kur i kemi emëruë rrugët kryesore në fshatin Rrenc, janë 8 ose 9 rrugë, prej rrugës së Haxhi Musës. Rruga e parë që shkon te shkolla është e kubëzume, rruga te kryqëzimi ku vjen te Varrezat poshtë është e kubëzume, rruga lart që lidhet me Kapren është e kubëzume, rruga për në Xërxe është e kubëzume. M'i tregoni cilat rrugë, një se keni shumë rrugë këtu, ndërtimi i rrugëve, një

veç ma tregoni – rruga te Loshajt, ose rruga me emër qe privat – ma tregoni një emër, ku do të kubëzohen në fshatin Rrenc 63,901 euro, projekt dyvjeçar? Një rrugë veç ma trego, kryetar. Po mirë bre, kryesuesja s'po e di, kryetari s'po e di, a po më kallxoni kush e di te ju. Një veç ma kallxo, një rrugë në fshatin Rrenc që kubëzohet. Veç një ma kallxoni, edhe një mur mbrojtës, se shumë ka. Muri mbrojtës te kthesa e Haxhi Musës. Një ma kallxoni.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! E para e punës, është shumë mirë që duhet me e pranue se kjo është ndarje buxhetore. Të gjitha mjetet janë ndarje buxhetore, dhe këto mjete për investimee kapitale i administron Drejtorati për Urbanizëm. Ai drejtorat ka të kontraktuar një kompani e cila përgatit projekte detale. Këto janë kërkesa të fshatrave dhe ne kemi pas mundësi dhe jemi shumë të kënaqur që kemi mjete me i nda Rrencit qaq sa kanë kërkuë qytetarët në bashkëbisedim. Projektet detale fillojnë që në pranverë të realizohen. Gjithashtu, disa projekte, që kemi tregue se jemi shumë më produktiv dhe kemi dhënë rezultate, dhe me 5 mijë euro kemi nis na projektin dyvjeçar dhe trevjeçar dhe kemi mbërri në 4 milionë euro të ujit me e realizue. Gjithashtu, kjo n aka ndihmue shumë që paratë mos me shkue në suficit. Kjo është një politikë financiare e mençur e LDK-së që e ka bo ma mirë deri më tash sesa qeverisja e mëhershme. Për arsye se nuk kemi kthye ka 1 milion e 600 mijë euro në suficit. Nuk keni qenë fleksibilë. Kjo është një strategji ekonomike që dimë me e përdorë na. Dhe duhet me ditë për me pas rezultat. Këtu ju kanë munguar rezultatet, tash po ju dhëm ajo pse na me 1 euro kemi të drejtë me hap projekt trevjeçar. Çka ndodh? Ta shpjegoj unë qysh shkon ekonomikisht, e ti del mbaj fjalime anglisht këtu. Nuk ka problem, unë nuk përzihem në profesionin tënd. Strategjia është kjo: Deri më tash, me 5 mijë euro kryetari e ka nis Ujësjellësin dhe sot e ke 3.5 milionë euro, që vitin tjetër merr fund. Kjo është politike e mençur, këtë duhet me dit me e bo. Po , edhe mbane në mend se ju duhet, për çdo kohë ju duhet kjo politikë financiare qysh bëhet. Se nuk keni ditë, ne po ju tregojmë praktikisht. Nuk ka shkue në Rrenc bre, shkon për një grusht vota edhe nuk është t'u e ditë çka është t'u kërkuë Rrenci. Në vend se me qenë i kënaqur pse janë ndarë gjithë ato mjete, ky çohet bën një politikë sa për me bo politikë. Po mirë është, kur të bëje politikën edhe ta shprehë mendimin ndryshe, po kur po mundohet me bind, po e kalon vetveten. Po të tregoj që muret i bën në mënyrë detale projektuesi. Nuk është as kryetari projektues, as kryesuesja e Kuvendit nuk është projektuese, as drejtori nuk është projektues. Kryetari, drejtori i Buxhetit edhe kryesuesja ta kanë mundësue si fshat ti me pas prioritet edhe me pas mjete në buxhet për me bo ti çka të duash, bashkë me qytetarët. Dhe tash ti mundohesh krejt këtë të mirë me e qit si negativitet. Mu po më vjen keq, se këtë duhet me dit me

e përdorë për të mirë, jo për të keq. Prandaj, nuk keni nevojë asnjë troh me u tensionue, po unë e di pse tensionohesh, se të vret e vërteta edhe të vret realiteti. Në qoftë se kubëzimet kanë fillue si bazament i qeverisë paraprake, kemi qenë të detyruar në aspektin fizik me i përmbush edhe kërkesat e qytetarëve tjerë, dhe kryetari mos me bo diskriminim. Atë politikë jemi duke e vazhduar, kemi kritikue po e kemi nis si të tillë. Po e përfundojmë më një herë e përgjithmonë për qytetarët politika PDK-LDK. Ia keni shtruar atij, nuk ia keni shtruar këtij. Kryetari ka dhënë urdhër t'i shtrohen të gjithë qytetarëve që kanë nevojë. Pa përjashtim cilit subjekt politik i takojnë. Pse ju vret kjo? Ju vret, se kryetari ka kaluar mbi partitë politike, ka kaluar mbi individët, ka kaluar mbi njerëzit thashëethemxhi, dhe tash jeni në një pozicion ku s'keni çka me thënë, e pse po shtroni kubëza. Ta përfundojmë këtë kapitull, se janë qytetarët tanë, qofshin të çfarëdo subjekti. Qofshin LDK, VV apo PDK. Kjo luftë politike të njerëzit provincial qysh keni mbetur ju, Rrenc-Blaç, e Blaç-Rrenc, duhet me përfundue, me kaluar edhe me qenë pak më të gjerë.

Artan Loshaj: Kryesuese edhe kryetar, një rrugë me emër e lypa unë, nuk jam kundër kubëzimit. Herën e parë ju kam thënë, shtroni me ari, me argjend, me çka të doni në fshatin Rrenc, se knaqem unë. Nuk do të kandidoj hiç, për hatër të drejtorit. Qe, merrni krejt votat. A e kuptoni ju këtë punë, me ari me e shtruar s'un më mundish në Rrenc mu, o i nderuar. S'mundish me m'mund në Rrenc mu, me diamant me e shtruar. Ti më trego mu konkretisht, cilën rrugë, krejt rrugët janë private, krejtve jau keni çelë dyert, me i shti kubëzimet me hi brenda, o kryetar. Le të ma tregojë kryesuesja, një herë mos të hesht, le të më thotë Rruga e Hasan Hysenit. Nuk janë 5 mijë euro po themi na, se vjet, vitin e kaluar ia keni shtruar njonit po e kam lënë, e kam gëlltit. Ia keni shtruar njonit privatisht në shpi, e keni çue kubëzimin. Hallall ju koftë. Mos të ikin, ma jepni një përgjigje, cila rrugë është. Mos ikni, se ju jeni ikacakë se keni ardhë për një mandat këtu. Kryetar po më vjen keq për ty, se me qesi ti s'mundish me fitue kurrë. Një rrugë ma kallxo ti mu. Edhe të mitë janë, votuesit e PDK-së janë, që s'kam mund Artan Nuredin Loshaj me jau bo kubëzimin. Të PDK-së janë krejt qeta rrugicat që po i shtroni nëpër shpia private. Po më vjen shumë mirë, unë kam me të votue, unë kam me të votue ty publikisht, në qoftë se bohen qeto, veç me thënë është politikë, për votë, jo pse po i duhet qytetarit. Po kryetar, unë kam me të votue, nuk kam me kandidue, kam me të votue unë, publikisht po të them. Edhe në qoftë se nuk më beson që kam me të votue, Arijeta ka me ardhë ndihmësja jeme, unë kam me thënë jam qorr, po due me më ndihmue dikush me votue Bexhet Xheladinin. Janë njerëzit e mi, njerëzit e PDK-së që më kanë mbështet deri më sot. Jam faqezi ndaj atyre unë, nuk jam kundër tyre, veç pranone, thuj për një grusht vota. Qeky është problemi,

ma kallxo një rrugë, se nuk janë 500 euro, 900 euro, 2 mijë euro. Janë 63,901 euro. Unë i di krejt rrugët, kanë qenë të matme në kohën teme, s'un i kam bo, po i boni ju. Po më vjen shumë mirë. Ai mos ta qet në politike, me thënë je kundër. Nuk jam kundër, unë kam me ta votue buxhetin, unë po due edhe 20 mijë me ia shtue Rrencit. Veç prano si politikë gjithëpërfshirëse, unë ku po due me e qit, prano që është pronë private. Nuk jam kundër. Krejt qeto rrugicat, ju duhet me i çelë dyert edhe me i shti nëpër oborre. Thashë edhe një herë, kam me dalë me të bo fushatë në Rrenc, kryetari..kryetari. Nuk e kam, o kryetar, për një grusht vota. Veç pse ai po më bohet shumë mangup, edhe po më thotë më kallxo more sa mure mbrojtës ka në Rrenc. Po s'ka more mure mbrojtës në Rrenc. Nuk ka! Janë anëtarë të PDK-së, që më kanë votue mu. Që ka mund Arijeta deni votë me marrë, a ka me i marrë krejta, hallall ju kofshin, se po punon. Po punon. Nuk jam kundër – regjistri – nuk jam kundër. Veç thuj po valla, e kam bo sikur ju të parët, kah kanë shkue kerrat e parë, po shkojnë edhe të mromit. E keni bo ju për vota, i keni çelë dyert, pak i keni shty, nan i troh ma shumë, se bullduzherin më të madh e kemi na. Boni kryetar, po më vjen mirë. Unë kam me ta votue buxhetin, edhe konkretisht nesër kam me thanë për fshatin Rrenc, për hir të qytetarëve të cilët nuk kam mund unë me i mbështet me kubëzim, Arijeta ka qenë më e zota se unë, i ka qit, unë do të shkoj mas Arijetës, se po di politikë ma shumë se unë. Edhe po ia pranoj. Veç pranone që prona... jo bre kryetar, se kam punë në eventuale për punësimet e ish-kryetarit. Ta kam thënë, kryetar, qetu, ish-kryetari i LDK-së, Qamil Kolloni, të ka qit prej punës, të ka çue në shpi, në 2009-tën, bashkë me LDD-në. 2009-2013 ka qenë krahë i djathë i Lulzim Rifajt, ish-kryesuesit këtu të PDK-së. Të kam thënë, këtë mandat ka me të çue ja në burg, ja në shpi. Me qaso njerëz, po më vjen keq... punësimet e familjarëve të atij në eventuale t'i qes.

Uran Halimi: E di që është replijë, po mundohem mos me e zgjat. Keq janë mësue këta t'u ik, me delegatë e drejtor, po e lënë edhe vetëm kryetarin, kurrkush s'del me e mbrojt aty. Ai sa herë del, ai drejtori i shkretë, veç e tollovit situatën, ia ngarkon procesin kryetarit. Sido që të jetë, Artan, unë nuk hi në personale, veç kur më cenohet personaliteti, atëherë merrem me personale. Bëjmë politikë na këtu, nuk nervozohem hiç, se bojmë politikë, mundim edhe me pi kafe atje na përjashta. Më pëlqej planifikimin buxhetor të mençur që e përmendi drejtori. Aty veç mençuri s'kam pa, se qekjo mençuria, kryetar, te planifikimi buxhetor i mençur – sipas drejtorit – mu ma ka dhënë një bazë për me ju çue në hetuesi të krimeve ekonomike. Domethënë, qekaq i mençur është ky planifikim buxhetor. Foli për suficitin buxhetor drejtori. Për me i ik suficitit buxhetor, këta kanë tendera fake, ose fallco, edhe mu më kanë dhënë të drejtë me i çue në hetuesi të krimeve

ekonomike. Edhe kjo ka qenë shumë e mençur, domethënë, mos me i çue paret në shtet, i kanë shti paret në xhep. Është i mençur planifikimi, znj.kryesuese edhe ju të nderuar delegatë. Singërisht, në Blaç e kam pa që ia kanë çelë derën e kurtit edhe ia kanë shtrë kubëzat deri atje në skaj të oborrit. Kam pas nevojë edhe unë, po vjet i kam ble. Me pas ditë, i kisha provue edhe qeto kubëzat e oborrit. Jam ngut pakëz, po. S'ka lidhje, me tëndësi halla, kryetari thojke e kam Zotin. Unë përnime e kam Zotin, jo veç në fushatë. Masnej na tha, Blaçi edhe Rrenci tha jeni njerëz provincialë. Po na në provincë jetojmë, qetu na ka lind Zoti, na s'un e kemi zgjedhë ku me lind. Kam pas qef edhe unë me lind në deni shtet shumë të fortë, jashtë provincës mbase, po jam i lumtur edhe qaty në provincë. Te qato provincat kanë me ardhë këta me kërkue vota, po këto përgjigjet do t'ia jap nesër drejtorit që sapo iku. E qysh ia keni nis me ik kryetar, prej seancave, mbyll seancën, mos voto e shantazho e kërcëno, do t'ikni krejt më doket mo, vitin e fundit e keni. Masnej na tha drejtori se këto janë kërkesa të fshatarëve, domethënë projektet janë kërkesa të fshatarëve. Unë kam qenë anëtar i Komisionit kur e kemi formue Këshillat e Fshatrave. Na janë dashtë për performancë, kryetar, e kemi bo atë shumë mirë. Edhe ke marrë grante të performancës prej Qeverisë. Ndonjëherë edhe s'ke qenë falënderues, po sidoqoftë ne kemi përfituar prej atyre granteve edhe mbështetjeve, projekteve të bashkëfinancuara. Kërkesa të fshatarëve kur tha, ne e kemi formue Këshillin e Fshatit për me i dëgjue kërkesat e fshatit. Kemi kryetar të fshatit edhe kemi anëtar të kryesisë së fshatit. Ajo që unë, kryetar, e kam thënë edhe jam bo bajat dhe e kam teprue për rregullimin e kaptazhave, jam shtyt edhe jam nxit edhe kam pas kërkesë me shkrim prej Kryesisë së fshatit Blaç. Më kanë thënë kështu: Uran, po ta bëjmë na kërkesën me shkrim – se jau kam kërkue kërkesën me shkrim, për me e dorëzue këtu në Komunë – po ta bëjmë kërkesën me shkrim, edhe kanë thënë kështu: “Ne si Kryesi e fshatit Blaç, për këtë vit buxhetor e kemi vetëm një kërkesë, rregullimi i ujëmbledhësve”. Nëse qysh tha drejtori janë bo kërkesat prej fshatarëve për këto projekte, në Blaç nuk mundën me bo secili fshatar kërkesë, ma shiro mu te dera e kurtit udhën ose ma bjer mu ni crevë ekstra për ujin. Domethënë, në Blaç na veç një kërkesë e kemi pas, o kryetar, si kryesi e fshatit. Ishalla po bëhet bre Ujësjellësi, bare me thuj mu që Uran ta mshela gojën. Rregulloi kaptazhat e ujësjellësit, e mandej edhe oborret edhe koridoret shtrojau.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Uran! Nuk do të ketë mo diskutime. Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 2 abstenime, e miratojmë këtë pikë. Kalomë te pika e tretë: Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës 5-70604038-0 244 -4 ZK Shajne, me sipërfaqe 12500 m/2. A do

dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, edhe këtë pikë e miratojmë. Atëherë vazhdojmë te pika e fundit, pika eventuale.

Artan Loshaj: Kryetar, nuk pata, po më nxiti drejtori. Unë po due me të pyet ty, sa familjarë drejtori i ka të punësuar në mandatin tënd? Një qaty po ia shoh, edhe një ndjeva që në shkollë ia keni marrë. Kryetar, ish-drejtori yt i Arsimit – profi Sel emri, se s’po më kujtohet, po, Selim Kryeziu – në këtë foltore, e kam në telefon të incizuar, se shumë e kam marak politikën, ka thënë që na nuk do të hapim konkurse të reja gjatë mandatit tim – sa ka qeenë ai – ka thënë ka qenë veç një konkurs i rregullt. Nuk do të hapim konkurse në Arsim, për shkak të uljes së numrit të nxënësve, ne arsimtarët, profesorët, mësuesit, do t’i sistemojmë për mos me i largue nga puna. Unë kam dëgjue – nesër munda me emër e me mbiemër dhe shumë konkretisht – që një familjar është i punësuar, i drejtorit, ndërsa një ish-ushtar i UÇK-së – pa emra, se po tuten – është një mësues edhe e kanë lënë mësues rezervë a qysh po i thojnë. Se me një shkollë nuk paska nxënës edhe qetash e kanë pru me një shkollë tjetër mësues rezervë. Atë e lënë rezervë me 15 vjet përvojë pune, ndërsa hapni konkurs edhe punësoni punëtorë të rinj të familjarit të drejtorit tënd. Nën dy, kryetar, në fushatën elektorale – është shumë serioze qekjo, ti koleg, edhe po foli unë edhe për të partisë time qetash – në fushatën elektorale të 2021-tës e ke akuzue direkt në... s’po e di cili televizion, më duket RTK-ja është, e ke akuzue ish-kryetarin Shabanin, që drejtori i Shabanit, i kryetarit, është i punësuar me një vend, është i punësuar me dy vende, është i punësuar me tri vende. Publikisht e ke bo. Unë po due me e ditë, çfarë marrëveshje kие me qat drejtor – se kur të më nin qetash mu, s’më fol ai nesër, hakmerret, po unë pesë pare s’i jap – çfarë marrëveshje kие që e ka lëshue drejtorllëkin me vetëdëshirë. Prej momentit që e ka lëshue drejtorin, kur ka ardhë drejtori i ri, ia keni plotësue të gjitha dëshirat që i ka kërkue nga ju. Pa emra sot, a sot një muaj, kur të dalim këtu, unë t’i them me emra e me krejt. Jo jo, pa emër. Çfarë dëshira e ke plotësue, se prej momentit që ka bo pranim-dorëzimin, punon ku ka punue, punon qysh ka punue, bile ni troh ma mirë, se përgjegjësi nuk ka. Pagën ia keni bo, me ato shtesa, me ato sende, më të madhe se që e ka pas. Këtë kam me ta rujt edhe për në fushatë kur të dalish në mot, kismet, në qoftë se jam kandidat, po ma shumë që jo. Është një marrëveshje në mes atij edhe ish-drejtorit tonë që e kие sot drejtor ti, të drejtorisë. Pse është kjo marrëveshje. Ti e dish shumë mirë, kryetar, veç kështu po due me e ditë, si mos të duesh këtu, në zyrë më kallxojsh. Çfarë marrëveshje është se unë e kam në telefon. Edhe fjalimin tënd, 59 sekonda të kam incizue kur ke folë. I kam edhe krejt shënimet, prej asaj ditës që

ka dhënë... nuk ish qenë ajo dorëheqje, ish konë marrëveshje e ish-drejtorit tonë, drejtorit tënë me ty, ju të tretë, që mu më lironi, atë të performancës mos ma arsyetoni, çdo vit që boni nota negative, s'i keni dhënë. Unë po due me e ditë, pse edhe auditim s'keni pru te na, auditim të brendshëm. Ani, se s'mundish me i ditë krejta ti, ose je pak edhe i moshuem, e mundish edhe me i harrue. Unë po due me e ditë këtë marrëveshjen. Edhe e treta, kryetar, kesh në Prokurim, ndriçimi në fshatin Rrenc. Unë ta kam thënë në këtë foltore, ju po mendoni se çdo fjalë që po e foli, po bëj ndaj jush edhe politikë. Politikë bëjmë, po politikë të pastër e bëj unë. Projekti para katër viteve ka qenë ndriçimi i fshatit Rrenc – maje në mend mirë, ta kam thënë qetu – 30 mijë euro. Ju e keni qit projektin, po u mbyllke më 3 tetor. Hapja e projektit po u bëke. Ju i keni nda këtë vit që po shkon, që iki, 20 mijë euro. Ndërsa, sot po më thojnë është projekt dyvjeçar, 20 mijë euro janë për 2024-shin dhe 15 mijë euro janë për 2025-shin. Ku do t'i merrni 15 mijë euro për vitin tjetër, me ma bo vazhdimin e ndriçimit në fshatin Rrenc. A ka mundësi një projekt, bre kryetar, si ka thënë Zoti me ma bo në Rrenc. Vitin e kaluar, deri reagoval publikisht në Facebook, se kurrë nuk reagoj, nëpër borë, e larguat borën me i vu do kubëza, m'i mshelët sytë. Këtë vit, po pritni në tetor me ma bo ndriçimin. Edhe ndriçimi a ka qenë një vit, ku e morrët ju me ma bo dy vite, projekt dyvjeçar. Në rregull, po e bëni, s'po e boni mirë, po p'e boni. Ku do t'i merrni 15 mijë euro, kur për vitin 2025 vetëm 59 mijë euro janë në fshatin Rrenc, janë kubëzim. 15 mijë euro ku do t'i merrni, prej cilës pikë buxhetor, ose s'po di ai drejtori i famshëm i yti, se s'po i di unë ato kodet, ato sendet, ato të mençurat e drejtorit tënd. Ku do t'i merrni 15 mijë euro për vazhdimin e ndriçimit në fshatin Rrenc. Ose në qoftë se do t'i jepni prej xhepit për me i fitue votat. Mos bre kryetar, çdo send me votë. Mos bre mos e kapni, ma boni bre këtë vit projektin. Qato pare që keni me i marrë në mot, 15 mijë euro, s'po e di ku, merrni bre sivjet. Edhe bone bre, mos m'i hidhëroni katundarët. A do të shkoni një herë edhe kah këta të PDK-së sivjet, me i zbut, e në mot atyre të LDK-së, edhe me e bo Rrencin Drenicë, do ta bëni pasha Zotin, qysh ia keni mësy, kryesuese, kryetarim drejtori. Me 5 vota keni më m'lënë në katund mu në mot, o kryetar. Kryetar, a ka mundësi me m'dhënë përgjigje, 15 mijë euro ku do t'i merrni për në mot. Mirë, e kreu unë. Edhe më fal, në debat publik, në vitin 2021, për tri projektet e mëdhaja, ish-kryetari yt i LDK-së, ky drejtori i mençur, apo ky smarti, e ka thënë këtu – ta lëshoj unë – e ka thënë që në vitin e parë – edhe ti ke thënë – në vitin e parë të ardhjes time në pushtet, uji do të rregullohet. Ndërsa unë, sa herë bjer shi në Dragash, në Bjeshkët e Sharrit, sa herë bjer shi, unë e qes kryetar se çfarë uji pi. Edhe kanalizimi, kur po ia lëshojmë ujin për nevoja fiziologjike, po na zihet prej gjybreve kanalizimi, kryetar. Prej mbeturinave të Dragashit.

Unë jetoj në qytezë, unë jetoj në Sharr, unë jetoj në lartësinë mbidetare... s'po e di, se s'jam gjeograf. Ky është uji unë që e pi, kryetar. Ti ke thënë në vitin e parë – jo jo, unë ia lëshoj krejt videot, i kam këtu. Ia kam lyp një projektor kryesueses, po s'po m'i plotëson kushtet. Patjetër, patjetër. Edhe e dyta, ka thënë shkollën profesionale – ta lëshoj, a kie mundësi me e ngue ni troh, se sot je si në disponim, më doket. Jo jo, ta lëshoj, ose lësho në Youtube aty, t'i kallxoj unë. Po s'e ke bo. E, qeshtu. Stadiumin, qysh në mandatin e parë, në javët e para – sikur Lumir qetash që po thotë 150 euro kam me e bo koeficioentin, qysh në javën e parë – qysh po thotë Ramushi, 1 mijë euro kam me jau bo ushtarëve, qeshtu ke thënë edhe ti, kryetar: qysh në momentin e parë të nënshkrimit të kontratës si kryetar i Komunës, unë Bexhet Xheladini, zotohem... çfarë zotimi keni bo, kryetar? Kurgjo s'kam pas sot, po më qiti taktit, më pru në apetit ai. Stadiumin për faqe të zezë, vetë jemi konë e kemi pa “Opojën”. E keni marrë një kontinier të turqve, po i vdeshim ata punëtorët. Po lypin ËC ata, na po i thona shkoni në mal. Pasha Allahin, njo – qe vetë ka qenë kryetari dëshmitar, edhe e kam në foto kryetarin, e kam qit në foto, se kam desht me e bo një selfie me kryetarin. Stadiumi u bo edhe atë prej Federatës. Po lypin nevojën me e krye ata, se u tutën prej “Opojës” që po hupin – s'kemi thashë Ëc këtu, s'kemi. Kryetari ka premtue që me Federatën këtë vit do të bëjë zhveshtoren e ato. S'ka! Plot, kryetar, ka, po p'e lëmë edhe për nesër pak.

Bexhet Xheladini: Po të përgjigjem në fillim ty, zotëri. Ish-drejtori i Arsimit paska thënë që nuk do të shpallim konkurs! Mu nuk më kujtohet, nuk e kam dëgjue. Nuk po e kontestoj, nuk e kam dëgjue atë deklaratë. Mirëpo, ish-drejtori i Arsimit, të gjithë punëtorët e arsimit të cilët kanë pas kontrata dyshe, që jau keni dhënë ju, i ka shndërrue në kontrata njëshe, me punë të përhershme. Nëse nuk beson, ti me Selimin ke muhabet, bisedo, ai të tregon. Të gjithë ata të cilët janë pranuar në punë nga qeveria e kaluar dhe i kanë pas kontratat dyshe, ai jau ka dhënë kontrata njëshe, me punë të përhershme. Sa u përket konkurseve, ai s'ka mund me e ditë që, nëse ai ka thënë – normal ka kërkea, shkojnë njerëzit, lëvizin, e lënë punën, shkojnë në pushim të lehonisë, dalin në pension. Këto vende të punës duhet me u plotësue. Ne jemi duke i plotësuar qeto vende të punës. Ata që shkojnë në pension, ato që i keni lënë ju të lira, ata që shkojnë në pushim të lehonisë edhe ata të cilët me vetëdëshirë e lënë punën, shkojnë jashtë. Kështu që, ne qeto konkurse i shpallim. Nëse ke vërejt diçka jashta, ajo është diçka tjetër. Pse auditimin e brendshëm s'e keni pru? Ajo e ka një plan, Auditorja e Brendshme e ka planin e vet edhe e miraton, edhe ajo vjen. Sigurisht këtë vit vjen, patjetër. Për ndriçimin në fshatin Rrenc ke të drejtë. Është një gabim që nuk kemi paraparë mjete shtesë. Ne, projektin që e keni bo ju, ne e kemi çue dhe një herë, është bërë projekt i ri.

Tenderi e cakton çmimin, e jo na. Se do ta shihni nesër, kemi me i pas nja katër ndryshime në buxhet, sepse Zyra e Prokurimit n aka obligue tash me i ndryshue qato paret që i kemi paraparë, sepse ka hy dikush ma lirë, ose me një vend ka hy ma shtrenjtë. Tash më ke shti me mendue, unë duhet me e gjet një zgjidhje. Megjithëse rruga Kapre – Rrenc nuk është udhë e Rrencit, po megjithatë ma shumë përfitues janë. 60% Kaprja, 40% janë Rrenci, në përgjithësi kështu nëse e marrim. E shfrytëzojnë ma shumë, edhe kanë prona, mujn mendërtue shtëpi aty afër etj. Por ne në fshatin Rrenc edhe 200 mijë euro i kemi paraparë për asfaltimin e asaj rruge. Nuk thashë që janë të Rrencit, për Rrenc, po megjithatë... 170 mijë, edhe 30 mijë i kemi të këtij viti, tamam 200 mijë bëjnë. Unë të thashë, një zgjidhje e gjejmë, ka mundësi që e reduktojmë edhe projektin. Jo, kubëzat nuk guxojmë me i prek. Te kubëzat ka kontratë, s'mundish me prek. Për ujin, unë nuk kam thënë që kam me e bo vitin e parë. Kam me e fillue projektin. Mos e kqyr bre, se nuk i ha fjalët unë. Unë gabimin e pranoj, nëse kam premtue e s'un e boj, kam thënë kam premtue, po edhe s'un e boj. Nëse s'un e boj, s'un e boj. Kanalizimin qendror e kam premtue, edhe Jeta Xharrës i thashë që s'un e boj. Edhe pse e kam premtue edhe më kanë mbet edhe një muaj a dy, a tre, s'un e boj. Ti e dish që nuk është kompetencë e Komunës ujësjellësi, as e qeverisë tënde, as e times. Por na kemi intervenue vitin e kaluar dhe e kemi bo një, edhe te ujëmbledhësi atje, edhe te koagulatori, kemi ndarë mjete bashkë me "Hidroregjionin" edhe e kemi përmirësue dukshëm kualitetin e ujit të pijshëm. Te Stadioni, ne e kemi një marrëveshje dypalëshe. Stadioni ka me u përfundue brenda mandatit tim. Ka mundësi që zhveshtoret brenda 10 ditëve fillojnë. Me konteinerat ne e kemi bo një zgjidhje kalimtare. E falënderoj KFOR-in Turk, i cili me fjalinë e parë na ka mundësue me na i pru ata konteinerat. Falënderoj edhe NIKI GD, i cili n aka ndihmue me e bo shkarkimin e tyre. Kjo është një zgjidhje kalimtare, në mënyrë që Klubi ynë i vetëm mos me i lujt ndeshjet jashtë. Sa i përket marrëveshjes me drejtorin, djretori ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit. Kurrëfarë premtimi nuk i kemi bo. A jep mësim mo a jo, nuk e di unë. Ti thaje plot vende të punës ka. Tash dëgjo, duhet me ia dit për nder nëse ka pranue me shkue edhe me dhënë mësim. E kemi shumë problem me gjet mësues, profesorë, me dhënë mësim në Shkollën e Mesme të Mjekësisë. Arsyeja është pagesa. Sepse, unë atëherë kur kam thënë ka qenë ndryshe. Sot, me ligjin e ri të pagave ka ndryshue gjendja. Me ligjine e ri te pagave, tash ai nuk ka të drejtë me marrë përmi 30% të pagës bazë. I bjer diku afër 100 euro apo nuk e di sa i bjer. Ai mbi 120-130 euro nuk mundet me marrë. Ti mujsh me u interesue, edhe nëse ai ka pranue me dhënë mësim, unë do t'i shprehi falënderim atij. Unë vitin e kaluar, kur është bërë ndryshimi i pagave, të gjithë doktorët të cilët kanë dhënë

mësim në Gjimnaz, kanë ardhë edhe kanë thënë, kryetar, për vitin e ardhshëm planifiko, gjej njerëz tjerë, se na më nuk pranojmë me 120-130 euro me punue. Ai ka të drejtë me kujdestarue, a ka të drejtë. Si drejtor kam thënë nuk qështë mirë, që edhe pagën e ka të madhe, edhe me jau marrë doktorave, se atëherë s'e kanë pas pagën qekaq doktorat. Pagën e kanë pas 500-600 euro. S'e kanë pas 1000-1200 euro. Atëherë kam thënë si drejtor, sot ka të drejtë ai me kujdestarue. (Për Uranin) U interesova, nuk i kish pas 12, por 14 orë i kish.

Uran Halimi: Kryetar, 12 orë i kanë mbet në fillim, kur ka ardhë urdhëri prej njerëzve të caktuar, që e kam marrë vesh me tamam kush e ka çue urdhërin. Në ndërkohë, ai drjetori i shkretë, i kanë teprue nja dy orë e s'ia ka qit kërkuj ato dy orët. Edhe tash, ku me i çue ato dy orët, kjo e shkreta t'u dashtë me e bo normën qysh duhet, i ka thënë që qeto dy orët nuk ia ke caktue kërkuj. Ka dashtë me bo vetëvrasje ai i shkreti që janë shtu edhe do orë. Ama, askidentalisht janë shtue qato orët që po thuesh ti. Shumë sinqerisht po të them. Përveç qatyne orëve që kanë dalë, i ka 16 orë, jo 12. Këto katra kanë dalë aksidentalisht. E kanë lënë me 12, katër kanë dalë aksidentalisht, se s'ka pas ku me i çue. Plus, tri klasë të parafillorëve ia ka marrë. Që parafillorëve iu japin Gjuhë Angleze në secilën shkollë mësuesit e Gjuhës Angleze. Gjithqysh, për me e zvogëlue numrin e orëve, ata ia kanë hek parafillorët. Ia kanë hel edhe do klasë tjera, jau kanë dhënë atyre mësuesave që janë bo aso sahanlëpirës. Na nuk nënshtrohemi, kryetar. Politika e këtij lloji, te unë nuk funksionon. Shumë sinqerisht po të them. Shkoni hiqnja krejt orët, mundeni me ia hek edhe ato 16-tat, nëse mendoni që mu më ndalni, është e gabueshme kjo. Cili është realiteti, sipas jush? A të ta them unë një realitet tjetër? Pranoje edhe ti këtë! Janë tre mësuesa të Gjuhës Shqipe që e kanë numrin e barabartë të orëve, jo të plotësime normat. Të tre mësuesat e kanë numrin e orëve të barabartë. Le ta ka gruaja jeme me dy mësuesa tjerë numrin e orëve të barabartë. Jo 20-20-12. Pse? Pse është shoqja e Uranit që po e bën punën e vet, për qato që populli më ka votue edhe më ka pru. Edhe ti po e bëjsh punën tënde pse unë të kam votue, kryetar. Bravo të koftë! Edhe qajo gruaja jeme të ka votue, kryetar. Ke të drejtë me ia hek orët, shpërbleji votuesit tu, përkrahësit e tu, kolegët tu, ata që të kanë ndihmue edhe të kanë pru qetu, shpërbleji në këtë mënyrë. Ke hi ti, kryetar, me qeverisjen tënde, nashta jo ti personalisht, po ty të vishen. Po unë kam qef me e teprue kapak,se mangu s'kam qef me lënë e për qato e teproj. Tash kryetar, shumë sinqerisht, po më kondet prapë, se i kam përcjellë ato debatet për shkak të Jetës, premtimet tua, i kam përcjellë krejt debatet, edhe pse kam qenë në shumicën prej atyre debateve aty prezent. Shumë sinqerisht po të them, më ke pëlqye shumë kur ke thënë e kam kamerë Zotin. Kam thënë: o Zot, ka me sjellë drejtësi. Jam gëzue, se unë 11 vjet

kam hek prej këtyre të PDK-së. 11 vjet kam konkurre vazhdimisht si mësues i Gjuhës Angleze, bashkë me shoqen teme, kam qenë me një bankë i ulet kur e kemi krye shkollën. Bashkë e kemi krye edhe magistraturën. Ajo i ka 12 vjet përvojë pune, unë i kam 1 vjet përvojë pune. Një zëvendësim që s'kanë dashtë me ia dhënë njo ma t'keqit se mu. Njëjtë je bo, edhe to sikur këta. Unë këtë s'e nali kurrë në jetë, kryetar, sa ta kam shpirtin. E ti vazhdo me qato. Te unë s'ka krevi, te krevi te unë mos u nis, kryetar, se gabim e kie. Domethënë, po e pranon kryetari. OSBE, a je këtu? Kallxoj njerëzve çka bën kryetari.

Artan Loshaj: Kryetar, që thaje tit ë gjithë ata që konkurojnë i falënderoj. Shumë, si dita me natën, një herë i ke akuzue e qetash po falënderosh. Në rregull. Një profesor tri vite ka qenë te ju, këtë vit ia keni shpallë konkursin. Tri vite ka mund me punue me ju, këtë vit ia ke shpallë konkursin. Si i njëjti profesor, edhe profesori ose profesoresha, kush të është nuk është me rëndësi, me të njëjtën shkollë prapë vazhdon mësimin në ShML “Ruzhdi Berisha”. Hakmarrjet politike më kanë kushtue edhe mu. I dish shumë mirë, më kanë kushtue edhe mu. Jo jo, ani të kallxoj unë, më kanë kushtue shumë. Po pres, jo në prokurori këtu, po në speciale. 14 vjet ju kemi prit na, kërkond s'e kemi çue me i dënue, me jau ndërrue kontratat, me i qit prej orëve, me jau ulë orët, me bo këso sende. Mu një send po më pëlqen edhe kam me ta dhënë dorën publikisht, që ke ditë me bo politikë me tanirlëpirësat e PDK-së. Qe 14 vjet neve që na kanë shtrydhë, të njëjtit i ke marrë nën ombrellën tënde, se këta janë mësue me hongër në grazhd të mirë. Të njëjtit e PDK-së, të mitë, hallall të koftë, tri herë po të them. O Uran Halimi, qe unë po ta jap përgjigjen. I kam thënë në fillim, procesverbalet janë këtu, jam konë ma aktiv, masnej ja një vjet më heshtën këta mu, se... s'po hi. Mirë ma kanë bo. Unë në fillim të kam thonë, i kam thënë kryetarit, ish-kryetari, drejtori të ka çue në shpi, ish-kryetari ka me të çue në shpi, ose në burg. Po ky në burg s'po i ha ato foret, po shkon në shpi. Ai ka hi – i kam thënë – për një mandate, me punësue, me kap diçka. Edhe nja tre a katër ka me i punësue deri qetash. Kjo është proces që dëgjohet, kryetari ia çon këto fjalët. Problemi është tjetër, i kam thënë, kryetar, ti edhe tre-katër drejtorë keni me u ndryshue. Të njëjtit punëtorë që janë, o janë të PDK-së qeta, qeta janë ata, s'mundin me ndryshue kjo sofër. Mundet i zoti i shpisë me u ndryshue, me qeta punëtorë, me qeta këshilltarë, me qeta jurist, me qeta ekonomista, me qata ëshët t'u punue kryetari i partisë. Qata që e kanë gërrye, ia kanë hongër shpirtin e PDK-së, Degës në Dragash, qata i ka nën ombrellën e vet kryetari. Unë ia kam thënë Selim Kryeziut, se e kam mik të shpisë – publikisht po ia them – unë kam qef në 2017-tën tit ë bëhesh kryetar, e unë të bëhem asambleist, e të qeshem këtu me tanirlëpirësat e PDK-së që kanë me dalë ma patrioti se ju. Edhe

kryetari, patriotat më të mëdhenj të LDK-së i ka tanirlëpirësat e PDK-së. Këtu është problemi. Ne kemi shkue nëpër gjykata me njerëzit tanë. Kryetari qata i ka. Qeshtu kryetar, nesër do të bisedojmë edhe mas votimit të buxhetit – kam me ta votue buxhetin, pa problem hiç, edhe me m'qit partia hariç kështu, kam me ta votue buxhetin, për ato 15 mijë eurot që kie me m'i gjet sonte natën. Po de, kie me e bo zgjidhjen, 15 mijë euro kie me i qit, pa ndriçim s'kie me m'lonë në Rrenc. Edhe, mas buxhetit, na të dy kemi me e pi ka një kafe, me bo privatisht muhabet.

Arijeta Skeraj: Faleminderit të gjithëve! E mbyllim KPF-në! Shihemi nesër në seancë!